

## **Procesverbal**

I hartuar më 20.05.2021 në debatin me banor ne fshatin Kërpimeh, ku ishin te ftuare edhe banoret e fshatrave Pakashticë e Poshtme, Pakashticë e Epërme, Ruevq, Bajqinë, Dobrtain, Dobërdol, Zakut, Metehi, Repë, Sylevicë, Pollatë, Sllatinë, Dvorishtë, Potok, Reqicë, Dvorishtë, Tërnavicë, Brecë, Zhiti dhe Murgull

Temë diskutimi ishte; Propozim Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës.

Drejtori i Administratës në komunën e Podujevës Bahri Selimi i cili edhe u drejtoi debatin, i informoi të pranishmit mbi të gjitha procedurat e kësaj propozim rregulloreje, e cila është hartuar në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 mbi organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Në bazë të këtij udhëzimi administrativ komuna e Podujevës duhet ti formoi 30 këshilla lokale. Me propozim rregulloren komunale është paraparë që 24 këshilla lokale të formohen nëpër fshatra dhe 6 ne qytet. Këto janë vetëm propozime dhe pas debateve dhe propozimeve dhe kërkesave banorëve mund të ndryshohen.

Kjo propozim rregullore qysh ne vitin 2020 ka dal ne diskutim publik por për shkak pandemisë kovid 19 është shtyrë, po ashtu edhe ne vitin 2021 nga asambleja komuna është shtyrë për një kohe ma te përshtatshme. Në mbledhjen e fundit asambleja komunale e ka qit në diskutim publik.

Në bazë të kësaj rregullore nga këto fshatar do të formohen 4 këshilla lokale  
1.Bajqinë,Dobërdol dhe Zakut, 2.Revuçë, Pakashticë e Epërme dhe Pakashticë e Poshtme,

3.Kërpimeh, Metehi dhe Sylevicë, dhe 4. Pollatë, Murgull, Tërrenavicë, Zhiti, Brecë, Reqicë, Sllatinë, Dvorishtë dhe Potok.

Në kuadër të këtyre këshillave ka mundësi me bërë lëvizje të fshatrave nga një këshill ne tjetrin.

Jemi të vetëdijsëm se do kemi pakënaqësi dhe vështirësi rreth funksionalizimit te këtyre këshillave.

Ndërsa për rritjen e numrit të këshillave nuk na lejon udhëzimi administrativ theksoi Bahri selimi.

Faik Gashi Dobërdol propozoi që fshati Dobërdol dhe fshati Zakut të jenë në një këshill lokal sepse çdo here i kemi pas aktivitete e përbashkëta.

Valon kastrati Kërpimeh tha se emërtimi i rrugëve është bërë pa na pyet ne banorëve.

Naim Hoxha Pakashticë e Epërme propozoi që çdo fshat te ketë këshillin e vetë, sepse kërkesat e banorëve janë të mëdha.

Qefser Bahrami tha se ne këshillin e bashkësisë për siguri shume përfaqësues te fshatrave nuk marrin pjesë dhe propozoi që çdo fshat të ketë këshillin lokal te fshatit.

Isuf Gashi Kjo form e këshillave të fshatrave po përngjan ne bashkësitë lokale të ish sistemit.

Përfaqësuesi i Bajqinës nuk mundet me përfaqësua banorët e fshatit Dobçrdol, edhe ky propozoi që fshati Dobërdol te jetë në një këshill lokal me fshatin Zakt.

Burim Kadri Rvuq propozoi që fshati Revuq të ketë këshillin e vetë, nuk do të pajtohemi që të jemi në një këshill me fshatrat tjera.

Bahri Selimi tha i kuptoi se nuk do të jetë e lehtë formimi i këshillave lokale, duke pas parasysh numrin e madh të fshatrave dhe pozitën gjeografike të komunës së Podujevës.

Do të kërkoj takim me ministrin e pushtetit lokal, do të ia paraqes të gjitha kërkesat e komuniteteve neper këto debate dhe do të kërkoj nga ministri ndryshimin e udhëzimit administrativ.

Deri sa të jete ne fuqi ky udhëzim administrativ ne jemi të obliguar ne bazë t tij.

Kërpimeh, më 20,05,2021

Procesmbajtësi

Latif mehmeti